



Planuar / Doretuar Prenjura/Prudato Received/Delivery	07-11-2022	2	viti god year
Organ /Bjesta Organ /Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHICK	6775/2022		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.850/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.850/2022 të datës 04.10.2022 të parashtruar nga ankuesja _____ përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit _____ me adresë:

_____ kundër Vendimit me numër protokolli 1374 të datës 15.09.2022 të Zëvendës Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë organit të punësimit-Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Transferim në rast riskstruktumi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 07.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON PROCEDIMI ADMINISTRATIV i inicuar sipas ankesës me numër A.nr.850/2022 të datës 04.10.2022 të parashtruar nga ankuesja _____

A r s y e t i m

Ankuesja _____ e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 04.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5837/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 1374 të datës 15.09.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, lidhur me transferimin e saj për shkak të ristrukturimit të institucionit në pozitën e "Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa", në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike", në Ministrinë e Punëve Brendshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5837/2022 të datës 07.10.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datë 19.09.2022; Aktvendim i datës 11.02.1991 me numër 02 nr.14/3-89; Kontratë e punës nr.1-293-02/1 e datës 15.04.2004; Kontratë e punës nr.293-ref-02/6-71 e datës 102.03.2007; Kontratë e punës e datës _____

13.05.2009; Akt emërimi i datës 05.09.2012; Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt emërimi Nr.072/2012 i datës 16.09.2013; Vendim Nr. Ref.768/2018 i datës 10.09.2018 grada diplomatike; Vendimi nr.140/2022 i datës 15.09.2022, për transferimin e nëpunësit civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit; Kërkesë e datës 21.09.2022 me numër protokolli 1399 nga përfaqësuesi i autorizuar Avokati me Propozim të bashkangjitur nga E-mail i datës 10.03.2022 drejtuar DMZP-së; Kërkesë nr. 3778 e datës 22.09.2022 nga ankuesja drejtuar Njesisë së burimeve njerëzore në MPJD-së, për kopjen e përshkrimit të detyrave të punës për pozitë: Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm; Certifikatën e datës 29.08.2003; Certifikatën e datës 07.12.2006; Certifikatën e datës 01.02.2003; Certifikatën e datës 20.10.2006; Certifikatën e datës 02-05.12.2009; Certifikatën e datës 02.05.2008; Certifikatën e datës 03.06.2010; Certifikatën e datës 21.10.2011; Certifikatën e datës 26.09.2011; Certifikatën e datës 29.01.2008; Certifikatën e datës 31.01.2008; Certifikatën e datës 09.10.2007; Certifikatën e datës 10.10.2007; Certifikatën e datës 25.09.2007; Certifikatën e datës 21.04.2006; Certifikatën e datës 24.11.2005; Certifikatën e datës 06.05.2005; Certifikatën e datës 10.07.2004; Certifikatën e datës 21.11.2008; Certifikatën e datës 25.09.2015; Certifikatën e datës 01.10.2001; Certifikatën e datës 14.05.2002; Certifikatën e datës 20.08.2010; Certifikatën e datës 08.06.2017; Certifikatën e datës 18.02.2020; Certifikatën e datës 27.12.2016; Certifikatën e datës 15.02.2017; Certifikatën e datës 18-19.05.2022; Certifikatën e datës 15.04.2022; Certifikatën e datës 24.05.2022; Formularin e vlerësimit për nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm për Vitin 2019; Formularin e vlerësimit për nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm për Vitin 2018; Formularin e vlerësimit për nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm për Vitin 2016; Formularin e vlerësimit për nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm për Vitin 2020; Formularin e vlerësimit për nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm për Vitin 2017; Formularin e vlerësimit për nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm për Vitin 2012; Formularin e vlerësimit për nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm për Vitin 2011; Shkresë nga ankuesja, për DMZP/MPB, prej ¼ faqe; Raport specialistit i datës 04.02.2022 prej ½ faqe; Raport specialistit i datës 27.01.2022 prej ½ faqe; Raport i mjekut i datës 12.11.2021 prej 1/5 faqe; Përgjigje në ankesë e datës 18.10.2022 me numër protokolli 6279/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore që të përfundoj *procedimi administrativ i filluar me ankesën e ankueses sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së ankuesja sipas Ndryshim dhe Plotësimit të Akt Emërimit me Nr.072/2012 të datës 16.09.2013 ka qenë e emëruar në pozitën Udhëheqëse e Divizionit për Auditim të Brendshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme, e cila pozitë është paraparë edhe me Rregulloren e re Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës mirëpo që për shkak të ristrukturimit gjegjësisht bashkimit të dy ministrive janë dy nëpunës civil që mbajnë pozitën e Udhëheqësit të Divizionit të Auditimit të Brendshëm, dhe rrjedhimisht ankuesja ka hyr në procesin e transferimit për shkak të ristrukturimit ku e njëjta sipas raportit me numër protokolli 596 të datës 19.04.2022 të Komisionit të Ristrukturimit, nuk ka plotësuar kualifikimet e posaçme formale lidhur me edukimin e vazhdueshëm profesional-minimumi 60 orë trajnim brenda 2 vetëve të njëpasnjëshme sipas kërkesave të përcaktuara ligjore për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm.

Ankuesja me datë 10.08.2022 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër shpalljes së konkurseve për pozitat e Drejtorëve të Departamenteve dhe Udhëheqësve të Divizioneve në MPJD dhe me datë 22.08.2022 kundër

heshtjes administrative për mos sistemim në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Këshilli gjatë vendosjes së ankesës së ankueses të datës 22.08.2022 ka pranuar si provë shtesë edhe Vendimin me numër Nr.140/2022 dhe numër protokolli 1374 të datës 15.09.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë lidhur me sistemimin e ankueses në pozitën "Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa", në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, në Ministrinë e Punëve Brendshme, ndërsa Këshilli me Vendimin A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022 ka shfuqizuar Vendimin Nr.140/2022 të datës 15.09.2022 të Zëvendës Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë duke e obliguar Komisionin e Ristrukturimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të rishqyrtoj rastin e sistemimit të ankueses.

Andaj nisur nga gjendja faktike si me lartë, dhe duke qenë se objekti i ankesës A.nr.850/2022 i datës 04.10.2022 i referohet vendimit i cili është shfuqizuar nga Këshilli me Vendimin A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022, Kolegji mbi bazën e këtyre rrethanave vlerëson se objekti i ankesës respektivisht qëllimi i ankesës së ankueses me numër A.nr.850/2022 të datës 04.10.2022 është bërë i pamundur - kotë, kështu që në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative cili përcakton se: "Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë", Kolegji vendosi që të përfundoj procedurën administrative të iniciuar sipas ankesës së ankueses me numër A.nr.850/2022 të datës 04.10.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.850/2022

Zyle Millaku Gojnovci

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të autorizuar avokatit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.